

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

P.nr. 336/10

Data 22 Korrik 2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Gunnar Oyhaugen si Kryetar i Trupit Gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons dhe Gjyqtari vendor Shaban Shala si anëtarë të panelit, të ndihmuar nga Procesmbajtësja Vlora Johnston, në rastin penal kundër të akuzuarit

MARJAN KONAJ, i biri i Pashkut, emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës Marthe Domgioni, i lindur me 30 Shtator 1975 në fshatin Jahoc të Komunës së Gjakovës, elektrikist, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme financiare, Shqiptar i Kosovës, në paraburgim që nga data 03 Mars 2010 aktualisht gjendet në Qendrën e Paraburgimit në Pejë.

I akuzuar me Aktakuzën e Prokurorit të Qarkut në Pejë PP.nr. 80/2010, e datës 22 Tetor e ndryshuar me 22 Korrik 2011, në lidhje me veprat penale të :

- *Vrasje e Rëndë*, në kundërshtim me Nenin 147, paragrafi 7 i KPK-së ,
- *Lëndim i Rëndë Trupor* në kundërshtim me Nenin 154, paragrafi 1, pika 3 e KPK-së dhe,
- *Mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve*, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2 i KPK-së

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datat 08, 09,10 Mars, 12, 14, 28 Prill, 05 Maj, 07 Qershor, 21 dhe 22 Korrik 2011 në prani të :

- të akuzuarit Z. Marjan KONAJ dhe avokatëve të tij mbrojtës Z. Haxhi MILLAKU dhe Z. Muharrem HOTI;
- Prokurores Publike Znj. Alenka SAGMEISTER-RANZINGER,
- palës së dëmtuar L P dhe përfaqësuesit të tij ligjor Z. Zeqir BERDYNAJ;

Trupi gjykues, pas shqyrtimit dhe votimit të mbajtur me datë 22 Korrik 2011, duke u bazuar në nenin 391, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK);

Me 22 Korrik 2011, sipas Nenit 392, Paragrafi 1 i KPPK-së shpall publikisht si në vijim,

AKTGJYKIM

I akuzuari Marjan KONAJ,

LIROHET

Nga kryerja e veprës penale të *Vrasjes së Rëndë* sipas nenit 147, paragrafi 1, pika 4 e KPK-së , sepse nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën më të cilën ngarkohet në Aktakuzë .

* * *

I akuzuari Marjan KONAJ,

LIROHET

Nga kryerja e veprës penale të Lëndimit të Rëndë Trupor, sipas nenit 154, paragrafi 1, pika 3 e KPK-së, sepse nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën më të cilën ngarkohet në Aktakuzë .

* * *

I akuzuari Marjan KONAJ është,

FAJTOR

Sepse,

Që nga një datë e panjohur e deri me 03 Mars 2010, në shtëpinë e të akuzuarit, në fshatin Jahoc të Komunës së Gjakovës ka qenë në posedim të një revolveri të tipit TT nr. AA 703-1947, së bashku me një karikator dhe tetë plumba të kalibrit 7.62 mm, pa pasur një autorizim valid

- Me të cilën ka kryer veprën penale të *Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve*, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2 i KPK-së

ANDAJ, i akuzuari,

DËNOHET

Me një (1) vit burgim.

Koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri do të i llogaritet në lartësinë e dënimit, sipas Nenit 391, paragrafi 1, nën paragrafi 5 i KPPK-së .

Një dënim sekondar caktohet për konfiskimin dhe shkatërrimin e revolverit TT nr. AA 703-1947, së bashku me karikatorin dhe tetë fishekët e kalibrit 7.62 mm.

Shpenzimet e procedurës penale në lidhje me veprat penale për të cilat i akuzuari është liruar do të paguhen nga buxheti, sipas Nenit 102, paragrafi 2 i KPPK-së .

Shpenzimet e procedurës penale në lidhje me veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor do të paguhen nga i akuzuari në shumë prej 100 Eurove si dhe 80 euro në emër të paushallit gjyqësor, sipas Nenit 102, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 99 paragrafi 2, nën paragrafi 6 i KPPK-së .

Arsyetimi

Sfondi Procedural

Me 03 Shtator 2010, Prokuroria Publike e Qarkut në Pejë e EULEX-it, ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 88/10, të datës 27 Gusht 2010 kundër Marjan Konajt, duke e akuzuar atë me *Vrasje të Rëndë* në kundërshtim me Nenin 147, pika 4 të KPK-së, *Lëndime të Rënda Trupore* në kundërshtim me Nenin 154, paragrafi 1, pika 3 e KPK-së dhe *Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve*, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2 i KPK-së, dhe kundër Lulzim Binakaj për veprën penale të *Shtytjes së Vrasjes së Rëndë* sipas Nenit 147, pika 4, në lidhje me Nenin 24 të KPK-së .

Para se të bëhej caktimi i seancës për konfirmim, me 29 Shtator 2010 Prokurori Publik e ka tërhequr Aktakuzën kundër Lulzim Binakaj, duke i hedhur poshtë akuzat kundër tij. Kështu kjo aktakuzë qe ndryshuar me 20 Tetor 2010.

Aktakuza qe konfirmuar me 08 Nëntor 2010 nga gjykatësi për konfirmim i Gjykatës së Qarkut në Pejë, përmes aktvendimit KAQ.nr, 265/10.

Me 22 Dhjetor 2010, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it duke vendosur sipas kërkesës së Prokurores së EULEX-it në Pejë, pas shqyrtimit, ka vendosur që ta merr lëndën në kompetencë dhe të ia caktojë Gjyqtarëve të EULEX-it për procedime të mëtejme.

Kompetencat dhe Përbërja e Trupit Gjyqës

Në përputhje me Nenin 23, paragrafi 1 të KPPK-së, Gjykatat e Qarkut do të kenë kompetencë për të gjykuar, në shkallë të parë, veprat penale të dënueshme me burgim me të paktën 5vjet apo burgim afatgjatë .

Në këtë rast i akuzuari është akuzuar me *Vrasje të Rëndë*, në kundërshtim me Nenin 147, paragrafi 4 i KPK-së, i dënueshëm me të paktën dhjetë (10) vjet burgim apo burgim afatgjatë. Andaj, Gjykata e Qarkut në Pejë e ka kompetencën lëndore për ta gjykuar këtë rast.

Vepra penale, sipas aktakuzës, ishte kryer në fshatin Moglicë, Komuna e Gjakovës, e cila është në territorin e Gjykatës së Qarkut në Pejë. Andaj, në përputhje me Nenin 27, paragrafi 1 të KPPK-së, Gjykata e Qarkut në Pejë ka kompetencë për të gjykuar këtë rast.

Meqë ky rast u është dhënë në kompetencë gjyqtarëve të EULEX-it me vendimin e Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, e datës 22 Dhjetor 2010, trupi gjykues është përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar Kosovar sipas Nenit 3.7 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë .

Seancat e Shqyrtimit Kryesor

Një seancë paraprake është mbajtur me 10 Shkurt 2011. Shqyrtimi kryesor është mbajtur i hapur për publik me datat 08, 09, 10 Mars, 12, 14, 28 Prill, 05 Maj, 07 Qershor, 21 dhe 22 Korrik 2011, në prani të të akuzuarit Marjan Konaj dhe avokatëve të tij mbrojtës Haxhi Millaku dhe Muharrem Hoti, Prokurores Publike të EULEX-it Alenka Sagmeister-Ranzinger, palës së dëmtuar L P /Laferita Perlala dhe përfaqësuesit të tyre ligjor, avokat Zeqir Berdynaj.

Në përputhje me Nenin 15 të KPPK-së, përkthyesit ndërkombëtarë kanë përkthyer procedurat gjyqësore dhe të gjitha dokumentet relevante për gjykimin nga gjuha Angleze në gjuhën Shqipe dhe e kundërta, sipas nevojës.

Provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor

Gjatë shqyrtimit kryesor, trupi gjykues ka marrë në pyetje dëshmitarët në vijim:

L P i marrë në pyetje me datë 08 Mars 2011
G P i marrë në pyetje me datë 08 Mars 2011
Laferita Perlala e marrë në pyetje me datë 09 Mars 2011
F P i marrë në pyetje me 09 Mars 2011
Eugen Perlala i marrë në pyetje me 09 Mars 2011 dhe 10 Mars 2011
Zef Nue Allakaj i marrë në pyetje me 10 Mars 2011
Luz Allakaj i marrë në pyetje me 10 Mars 2011
Patrik (Tune) Allakaj i marrë në pyetje me 10 Mars 2011
Luke Perlala i marrë në pyetje me 12 Prill 2011
Ndrecë Dodaj i marrë në pyetje me 12 Prill 2011 dhe 14 Prill 2011
Mark Pitaqi i marrë në pyetje me 14 Prill 2011
Lulzim Binakaj i marrë në pyetje me 14 Prill 2011
Petrit Perlala i marrë në pyetje me 28 Prill 2011
Nikollë Allakaj i marrë në pyetje me 28 Prill 2011
Patrik (Ndue) Allakaj i marrë në pyetje me 28 Prill 2011
Enver Krasniqi i marrë në pyetje me 28 Prill 2011

Hasan Rexhaj i marrë në pyetje me 05 Maj 2011
Alberim Mujaj i marrë në pyetje me 05 Maj 2011
Mark Perlala i marrë në pyetje me 07 Qershor 2011
Sabahudin Bitiqi i marrë në pyetje me 21 Korrik 2011

I pandehuri Marjan Konaj po ashtu ka dhënë dëshmi/është marrë në pyetje me 21 Korrik 2011

Dëshmi të dokumentuara

- Raporti i Hetimeve Rajonale me numër 2009-DB-2818 i datës 16 Janar 2010;
- Analizat e regjistrimit të thirrjeve telefonike me numër 2009-HRP-261 të datës 02 Shkurt 2010;
- Të dhënat nga bastisja e shtëpisë së Marjan Konajt me datë 03 Mars 2010;
- Foto albumi nga bastisja e shtëpisë;
- Certifikata e konfiskimit me numër 2009 – DB-2821 e datës 03 Mars 2010;
- Raporti policor me numër 2009-DB-2821 i datës 26 Janar 2010;
- Fotoalbumi i shtatë meshkujve;
- Raporti i autopsisë me albumin numër 010-001 A, i datës 06 Janar 2010;
- Raporti i ekzaminimit mjeko-ligjor me numër 2010-0120 i datës 10 Shkurt 2010;
- Të dhënat nga bisedat telefonike filluar me datë 14 Shkurt 2010 në ora 13:48 min në mes të të pandehurit Marjan Konaj dhe një personi me emrin Adem;
- Raporti nga inspektimi i vendit të ngjarjes me numër 2009-DB-2821 i datës 31 Dhjetor 2009;
- Fotoalbumi me numër 2009-DB-2821 i datës 31 Dhjetor 2009;
- CD-ja e pozicionimit të telefonit mobil të Marjan Konajt;
- Raporti i autopsisë me numër MA09-359 i datës 27 Prill 2010
- Fotografi e datës 30 Maj 2006 me tre burra-në mes tyre Dedë Perlala dhe Marjan Konaj;
- 2 foto nga kreacioni i njëjtë me datë 30 Maj 2006;
- 3 foto në lidhje me shtëpitë.

Inspektimi i vendit të ngjarjes:

Gjykata ka bërë një inspektim të vendit të ngjarjes me datë 05 Maj 2011, aty ku ka ndodhur vrasja- rrethinën e afërt.

Përmbledhja e të akuzuarit dhe deklaratat e dëshmitarëve:

Deklarata e të akuzuarit Marjan Konaj:

Ai e mohon të ketë qenë në fshatin Moglicë mëngjesin e datës 31 Dhjetor 2009. Rrjedhimisht ai e mohon ta ketë qëlluar Dedë Përlalën dhe ta ketë plagosur djalin e tij L P në atë mëngjes.

Ai ka qenë mysafir në shtëpinë e familjes Allakaj në Marmullë nga 30 Dhjetori 2009 e gjer në mëngjesin e 31 Dhjetorit 2009- kur ai ka shkuar për të blerë ushqim për familjen e tij dhe të merr pjesë si dëshmitar në një ceremoni martesore. Ai nuk shkoi në këtë ceremoni pasi që i ishte thënë se nuk ishte i nevojshëm. Ceremonia veç kishte përfunduar.

Ai ka qenë shok i Dedë Përlalës. Ai nuk ka pasur motiv për ta vrarë atë, ai e ka ngritur çështjen se si ka guxuar ai që të shkonte në spital po të njëjtën ditë - duke rrezikuar që të identifikohet nga ndonjëri nga djemtë. Ai po ashtu ka theksuar se meqë Deda e ka njohur atë, Deda me siguri do ta kishte thënë emrin e tij para apo pasi që është qëlluar, po qese ky do të kishte qenë gjuajtësi, por Deda nuk ka thënë asgjë në lidhje me këtë para se të vdiste.

L P – i lindur me 21 Nëntor 1996:

Në dëshminë e tij të cilën ia ka dhënë policisë me datë 21 Janar 2010, ka dhënë deklaratën në vijim në lidhje me personin i cili e ka gjuajtur babain e tij dhe atë :

“Mendoj që ka qenë rreth 180 cm i gjatë apo 2-3 cm më shumë , ai ka pasur të veshur pantallona të vjetra të zeza por nuk jam i sigurt nëse kanë qenë xhins apo material, në pjesën e sipërme ka pasur të veshur një xhaketë të najlonit dhe ka qenë e qartë se ka pasur të veshur diçka të trashë përfundi. Kjo xhaketë ka pasur dy palë xhepa, lartë e poshtë dhe dy zingjir në të dyja anët. Lëkura e tij ka pasur ngjyrë normale, jo aq e zezë dhe jo aq e bardhë , fytyrë rrumbullake. Unë nuk kam vërejtur asgjë në veçanti në gojën e tij apo mjekrën përveç faktit se ka pasur qime të rralla në mustaqet e tij. Hunda e tij nuk ka qenë e madhe por pak e gjerë, në sytë e tij unë nuk kam vërejtur asnjë shenjë po ashtu. Vetullat e tija ishin të theksuara dhe ai kishte në kokë një kapele të vjetër ngjyrë te zezë të thurrur”.

Atij pastaj i është bërë kjo pyetje:

Nëse ne ua tregojmë ju fotografitë e njerëzve të ndryshëm, a mund që ta njihni ndonjë person që mund ti përgjigjet përshkrimit të personit të dyshuar?

Përgjigja e L në këtë pyetje ka qenë :

Nga fotografitë me numër nga 1 deri në 7 që më janë treguar mua, personi me numër 3 është personi që më së shumti i ngjason personit të dyshuar që e ka vrarë babain tim. Unë do të doja që ta shoh një fotografi me ngjyra të tij apo ta shoh atë për së gjalli.

G P - i lindur me 24 Shtator 1995:

Në deklaratën e tij dhënë policisë me 20 Janar 2010, e ka përshkruar personin që ka qëlluar në Dedë Përlalën dhe që e ka plagosur L P , si në vijim:

“ Përafërsisht, ai ka qenë 180 cm i gjatë, me trup mesatar, ka pasur në kokë një kapele të thurrur me ngjyrë të zezë, fytyrën e ka pasur të hapur, lëkurë jo aq të zezë, nuk ka pasur mjekër, me sa më kujtohet faqe të fryra. Unë nuk i kam parë detajet tjera në fytyrën e tij meqë nuk

isha i fokusuar në atë person dhe nga vendi ku isha i ulur, në kombi (në mes) unë nuk mund të shihja. Ai kishte të veshura xhins të vjetra me ngjyrë të kaltër, kishte të veshur një xhaketë me ngjyrë të mbyllur, nuk jam i sigurt se çfarë ngjyre.....

Unë asnjëherë nuk e kam parë atë person dhe unë nuk kam dëgjuar se ai ka ndenjur me dikën dhe edhe nëse do ta shihja tani, unë nuk do ta njihja atë “

Atij i është bërë pyetja në vijim nga ana e policisë :

”Fotografitë që u janë prezantuar ju nga policia me numrat duke filluar nga 1 e deri ne 7, a duket ndonjë person këtu sikurse personi i dyshuar që ju e përshkruat më lartë ?

Përgjigja e tij ishte: “ Personi me numër 3 duket sikur personi i dyshuar mund të them më shumë se 50%, po që se do të mund të shihja një fotografi me ngjyra ndoshta do të isha më i sigurt”.

F _____ **P** _____ - i lindur me 3 Janar 1993:

Në deklaratën e tij dhënë policisë me 20 Janar 2010 në lidhje me personin i cili ka shtënë, ai deklaroi si në vijim:

“Gjatësia e tij dhe trupi ishin të njëjta si të xhaxhait tim Lluk, ai ka pasur një kapelë të zeze të thurrurr në kokë, ai ka pasur fytyrë të rrumbullakët, mjekër jo krejt të rruar dhe mjekra e tij nuk ka qenë e zezë. Unë nuk mund të mbaj mend më tepër po ashtu sepse kapela e tij ishte e tërhequr poshtë deri tek vetullat dhe derisa ka gjuajtur ai e ka mbajtur kokën e tij disi poshtë dhe fytyra e tij dukej shumë e zemëruar dhe e skuqur. Unë nuk e mbaj në mend se çfarë ka pasur ai të veshur sepse çdo gjë ishte aq e shpejtë dhe unë nuk i kam kushtuar vë mendje rrobave të tij.....Jo, nuk më kujtohet që unë ta kem parë atë më parë ”.

Policia ia bëri këtë pyetje: “ Duke i shikuar fotografitë e fotoalbumit nga numri 1 deri në numrin 7, cili nga këta persona i përngjan më se shumti atij i cili ka gjuajtur në ju atë ditë ”?

Përgjigja e tij: “Nga këto foto që më janë treguar, personi me numër 3 më së shumti i përgjigjet përshkrimit të personit i cili ka gjuajtur në ne; unë e them këtë duke u bazuar në fytyrën e tij”.

Eugen Perlala:

Ai ka deklaruar në gjykatë se Dedë Perlala dhe Marjan Konaj nuk kanë pasur ndonjë problem me njëri tjetrin. Eugeni po ashtu ka sqaruar se ai ka qenë personi i cili ia ka dorëzuar fotografinë policisë, atë fotografi ku Dedë Perlala dhe Marjan Konaj ishin në fotografinë e njëjtë - të bërë në restorant Adora.

Luz Allakaj:

Ai konfirmoi që ai e ka thirrur Marjan Konajn në lidhje me marrëveshjen që Marjan Konaj do të duhej të ishte dëshmitar në ceremoninë e martesës në ditën e njëjtë -31 Dhjetor 2009. Ai e ka thirrur Marjan Konajn në mëngjes dhe i ka thënë atij që vëllai i tij i kishte thënë :” *Mos u nxito sepse ne e kemi kryer punën* “ (që nënkuptonte se ceremonia e martesës kishte përfunduar).

Ai po ashtu është dashur që të jetë edhe një dëshmitarë i alibisë. Por dëshmia e tij ka qenë shumë e paqartë në këtë aspekt për të dhënë një alibi për Marjan Konajn gjatë kohës kritike.

Zef Nue Allakaj, Patrik Allakaj, Nikolle Allakaj dhe Patrik (Ndue) Allakaj:

Ata po ashtu kanë qenë të ftuar si dëshmitarë në mënyrë që të japin një alibi për Marjan Konajn në lidhje me kohën kritike kur kanë ndodhur të shtënat, rreth orës 08:00 të mëngjesit të 31 Dhjetorit 2009.

Sidoqoftë, dëshmitë e tyre ishin ose të paqarta apo ata dukshëm kishin gabuar në lidhje me kohën kur Marjan Konaj e ka lëshuar shtëpinë e Allakajve.

Luke Perlala:

Ai i ka thënë gjykatës se ai e ka ditur që Dedë Perlala ka marrë një tokë nga një person i quajtur Ukë Gjini në lidhje me një borxh të papaguar që Ukë Gjini kishte ndaj Dedë Perlales. Dhe po ashtu që vëllai i Ukë Gjinit-Nikolla- i ka thënë Ukës:” *Dil jashtë nga shtëpia ime dhe mos u kthe derisa ta kesh vrarë Dede Perlalen, meqë ai ta ka marr tokën*”.

Luke Perlala po ashtu ka konfirmuar se ai ka qenë prezent kur L P ia ka dhënë deklaratën e tij policisë dhe se ai po ashtu i ka nënshkruar deklaratat e L dhe G P si xhaxha i tyre. Po ashtu, ai ka thënë se kur G ishte marrë në pyetje nga policia, ai ka qenë prezent kur fotografitë e identifikimit i ishin prezantuar atij, ndërsa, kur fotografitë i ishin prezantuar F P , ai nuk ka qenë prezent atëherë .

Luke Perlala ka dëshmuar në gjykatë se ai- në lidhje me vrasjen e Dedë Përlalës- ka pasur dyshime për Ukë Gjinin. Po ashtu edhe disa nga shokët e tij-Gjon Nikolla, i cili është shok i ngushtë i Allakajve dhe Marjan Konajt. Ai po ashtu ka shprehur mendimin se ai ia ka përmendur emrin e Marjan Konajt, Prokurorit Publik.

Luke Perlala ka konfirmuar se ai e ka parë Marjan Konajn në spital me datën 31 Dhjetor 2010 rreth orës 11:00. Në atë kohë ai e ka njohur Marjan Konajn nga dukja, por pas incidentit ai ia ka mësuar emrin.

Ndrec Dodaj, Laferita Perlala dhe Mark Perlala:

Këta dëshmitarë nuk kanë thënë asgjë me rëndësi në lidhje me rastin.

Mark Pitaqi:

Ai i ka thënë trupit gjykues se ai ka qenë shok i ngushtë i Dedë Perlales. Sipas mendimit të tij me siguri Dedë Perlala e ka njohur Marjan Konajn. Ai nuk ka dëgjuar asnjë herë nga Dedë Perlala se ai ka pasur probleme me Marjan Konajn.

Ai po ashtu ka thënë se çështja/konflikti që Dedë Perlala kishte me Zef Leshdedajn ishte zgjidhur para se Deda të vritej. Ai ka treguar se çështja që Dedë Perlala kishte me Ukë Gjinin në lidhje me tokën po ashtu ishte zgjidhur para se Dedë Perlala të vritej. E njëjta gjë me problemet që ai ka pasur me Pashk Laskun dhe Ndue Mehmetin.

Ai ishte pyetur në lidhje me marrëdhënien që Dedë Perlala kishte me Luz Allakajn dhe familjen Allakaj, dhe përgjigja e tij ishte që ata kishin marrëdhënie të mira.

Lulzim Binakaj:

Në një fazë më të hershme ai ka qenë i dyshuar për rastin për shkak të një deklaratë të dhënë nga një person i quajtur Arben Morina. Është zbuluar se kjo deklaratë ka qenë e rrejshme dhe prokuroria e ka hedhur poshtë aktakuzën kundër tij. Ai nuk kishte asgjë me vlerë për ti thënë trupit gjykues.

Petrit Perlala:

Ai i ka thënë trupit gjykues se është e mundur që Dedë Perlala dhe Marjan Konaj e kanë njohur njëri tjetrin, por ai nuk i ka parë ata asnjëherë bashkë, dhe se ai asnjëherë nuk ka dëgjuar ndonjë ankesë në lidhje me Marjan Konajn nga Dedë Perlala. Ai po ashtu ka thënë se Marjan Konaj e ka vizituar atë në shtëpinë e tij në fshatin Moglice.

Enver Krasniqi:

Ai është marrë me hetimet në këtë rast si oficer policor. Ai ka përshkruar se si është zhvilluar foto-konfrontimi. Ai nuk ka mundur që të sqaroj se përse fotografia e Marjan Konajt ishte

vendosur në mesin e 7 fotografive që i janë treguar fëmijëve të Perlalajve-veq nëse përshkrimi i dhënë nga fëmijët ishte një lloj shkak për ta vendosur foton e Marjan Konajt në mesin e këtyre fotografive. Fotoalbumi ishte përpiluar nga Rreshteri Alberim Mujaj dhe jo nga dëshmitari.

Hasan Rexhaj:

Ai është marrë me hetimet në këtë rast si oficer policor. Atij nuk i kujtohet se kush e ka përpiluar fotoalbumin-por beson dikush nga Njësia e Hetimeve e ka bërë këtë. Mbikëqyrës në këtë rast ka qenë Rreshter Alberim Mujaj.

Alberim Mujaj:

Ai është marrë me hetimet në këtë rast si oficer policor. Ai ka treguar në lidhje me foto-konfrontimin dhe po ashtu se si fotografia e vetme me ngjyra e Marjan Konajt ishte trajtuar-dhe nga ka ardhur kjo fotografi.

Atij nuk i kujtohet se kush i ka përpiluar të 7 fotografitë. Duke u bazuar në përshkrimin e dhënë nga dëshmitarët, Marjan Konaj ishte njëri nga të dyshuarit dhe andaj ata e kanë futur fotografinë e tij së bashku me fotografitë e tjera. Alberim Mujaj ishte personi i cili ka vendosur se cilat fotografi duhet që të përdoren në këtë drejtim. Përzgjedhja e fotos së Marjan Konajt është bërë po ashtu me kërkesën e Luke Përlalës. Duke u bazuar në bisedën që dëshmitari e ka pasur me Luke Perlalën, ai ka pasur informacion se Marjan Konaj mund të ishte njëri nga të dyshuarit e mundshëm. Por, ai nuk e ka përshkruar se çfarë lloj informacioni ka qenë. Marjan Konaj ishte po ashtu i dyshuar në një rast tjetër të vrasjes.

Përpos kësaj, ai ka deklaruar se asnjëri nga 6 burrat e tjerë në fotografi nuk ishin të dyshuar për vrasjen e Dedë Përlalës.

Vlerësimi i Provave të Paraqitura:

Gjetjet Faktike:

Mbi bazën e dëshmive të paraqitura gjatë shqyrtimit kryesor, trupi gjykues i konsideron faktet në vijim si të dëshmuara:

1.

Dedë Perlala u qëllua për vdekje në mëngjesin e 31 Dhjetorit 2009 në fshatin Moglicë, derisa djali i tij L [] i ishte plagosur nga një e shtënë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend. Dedë Perlala, L [] P [], F [] P [] dhe G [] P [] ishin në makinën e Dedë Perlalës kur

një burrë erdhi me makinë. Ky burrë doli nga makina dhe shkoi në drejtim të makinës ku ishin duke qëndruar Perlatat. Ai kishte një pushkë në dorë. Nga largësia përafërsisht 1.5 m ai gjuajti disa herë në Dedë Perlatën dhe njëri nga plumbat e qëlloi po ashtu edhe L . Pastaj ky qëllues u zhduk nga vendi i krimit me makinë.

Dedë Perlala vdiq pak kohë pasi u qëllua. Por, menjëherë pasi që ishte qëlluar nga plumbat ai i bëri një koment të shkurtë duke i thënë: “ A të mori plumbi edhe ty po ashtu?”. Ai nuk përmendi asnjëherë asgjë në lidhje me identitetin e gjuajtësit/vrasësit.

2.

Gjatë bastisjes së shtëpisë së Marjan Konajt me 03 Mars 2010, policia ka gjetur një revole TT.nr. AA. 703-1947, së bashku me një karikator dhe tetë plumba të kalibrit 7.62 mm që i takonin Marjan Konajt. Marjan Konaj nuk kishte autorizim për armëmbajtje.

Arsyetimet e Gjykatës dhe Konkluzionet:

Duke i konsideruar të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve, po ashtu edhe deklaratën e të Akuzuarit dhe dëshmitë tjera të prezantuara, Gjykata arriti në konkluzionet në vijim:

Ka dëshmi të pamjaftueshme për ta gjetur të akuzuarin Marjan Konaj fajtor për Vrasje të Rëndë sipas Nenit 147, pika 4 e KPK-së: Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave.

Në vazhdim, ka dëshmi të pamjaftueshme për ta gjetur të akuzuarin Marjan Konaj fajtor për shkaktimin e Lëndimeve të Rënda Trupore nga Neni 154 i KPK-së, Paragrafi 1, Pika 3: “Kushdo që i shkakton lëndim të rëndë trupor personit tjetër ose e dëmton shëndetin e personit tjetër deri në masën e tillë sa që mund të rezultojë me dobësimin e përkohshëm ose të madh të një organi vital ose një pjese vitale të trupit të personit tjetër”.

Trupi gjykues gjen se personi i cili e ka vrarë Dedë Perlatën, ka kryer Vrasje të Rëndë dhe se personi i njëjtë po ashtu ka kryer Lëndime të Rënda Trupore.

Arsyeja se pse trupi gjykues nuk e gjen Marjan Konajn fajtor është se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm, se Marjan Konaj ishte ky person.

Pjesa e vetme e dëshmisë që e lidh Marjan Konajan në mënyrë të drejtpërdrejt janë dëshmitë dhe identifikimi i kryerësit të veprës nga ana e tre dëshmitarëve okular: L P , F P dhe G P . Rreth tre javë pas incidentit atyre u janë treguar fotografitë e 7 burrave, me numra prej 1 deri në 7. Marjan Konaj kishte numrin 3.

Sipas mendimit të Gjykatës vërejtjet/deklaratat e këtyre tre dëshmitarëve të bëra herën e parë kur janë ballafaquar me këto fotografi, janë më të rëndësishmet. Pastaj nuk është e mundur që të dihet nëse ata e mbajnë mend incidentin apo nëse memoria e tyre është e lidhur me memorien e ballafaqimit të parë me fotografitë.

Që të tre djelmoshat kanë treguar fotografinë numër 3 të jetë fotoja e cila i përngjan më së shumti kryerësit të veprës. Sidoqoftë, ata nuk ishin të sigurt.

G P ka thënë: "Personi që mban numrin 3 duket sikurse personi i dyshuar, mund të them për më shumë se 50%".....

F P ka thënë: "Nga këto fotografi që më janë treguar mua, personi që mban numrin 3 më së shumti i përgjigjet përshkrimit të personit i cili ka gjuajtur në ne; Unë e them këtë duke u bazuar në fytyrën e tij."

L P ka thënë: "Nga fotografitë që mbajnë numrat nga 1 deri në 7 e që më janë treguar mua, personi që mban numrin 3 është që ka më shumë gjasa që të jetë personi i dyshuar i cili e ka vrarë babain tim....."

Mënyra se si këta tre djelmosha janë shprehur tregon se ata nuk ishin të sigurt që Marjan Konaj ishte kryesi i veprës. Fakti që, që të tre kanë treguar në foton me numër 3, është natyrisht një element ta bëj identifikimin më të mundshëm. Por, megjithatë kjo nuk është e mjaftueshme kur asnjëri nga ata nuk janë të sigurt për këtë. Më i sigurti është L P i cili përdor fjalët: "ka shumë të ngjarë".

Mënyra se si djelmoshat janë marrë në pyetje ka pasur dobësi të dukshme të cilat i bëjnë deklaratat e djelmoshave më pak të rëndësishme. Pyetja drejtuar djelmoshave do të duhej të kishte qenë: "A është kryerësi i veprës ndonjëri nga këta 7 persona?"

Sidoqoftë, ata ishin marrë në pyetje në këtë mënyrë: (L) "a mund ta njihni ndonjërin nga personat që i përgjigjet përshkrimit të personit të dyshuar?" (G) "a duket ndonjëri nga këta persona sikur personi i dyshuar që e keni përshkruar më sipër?" (F) "cili nga këta persona më së shumti duket sikur ai i cili ka gjuajtur në ju atë ditë?" Përgjigjet e tyre duhet që të vlerësohen në bazë të asaj se si u janë parashtruar këto pyetje atyre.

Fotoalbumi po ashtu kishte dobësi të qarta. Fotografitë të cilat ishin treguar kanë pasur "formate" të ndryshme. Disa fotografi tregonin gjatësinë e personit. Përshkrimet nga F tregojnë që personi ka qenë i gjatësisë së Luke Perlalës -177cm. G ka deklaruar se ai ka qenë rreth 180 cm i gjatë. L ka thënë 180-183 cm i gjatë.

Fotografia numër 1 tregon që personi është rreth 175 cm i gjatë. Fotografia numër 2 tregon që personi është rreth 177cm i gjatë. Fotografia numër 3 tregon që personi (Marjan Konaj) është rreth 183 cm i gjatë. Fotografitë numër 4,5 dhe 7 nuk tregojnë se sa është personi i gjatë. Fotografia numër 6 tregon se personi ishte pothuajse 190cm i gjatë.

Fotografia numër 3 (Marjan Konaj) dhe numri 5 janë shumë të ndryshme nga fotografitë tjera.

Këto dobësi e bëjnë foto-konfrontimin më pak të rëndësishëm.

Gjykata duhet po ashtu të merr parasysh në lidhje me këtë se djelmoshat e kanë parë kryesin e veprës vetëm për disa sekonda. Ka qenë një eksperiencë shokuese për ta. Përveç kësaj, kryesi i veprës ka pasur kapele të cilën e kishte të vënë gjer tek vetullat e tija.

Gjykatës i është thënë se vetëm Marjan Konaj ka qenë i dyshuar në mesin e këtyre fotografive. Të 6 personat e tjerë nuk kanë pasur lidhje me rastin. Megjithatë, gjykata nuk është informuar në masë të duhur se përse Marjan Konaj ka qenë i dyshuar para foto-konfrontimit. Dy arsye janë dhënë në lidhje me këtë. Përshkrimet e djelmoshave dhe se Luke Perlala ka pasur informacion që Marjan Konaj ka mundur të jetë njëri nga të dyshuarit e mundshëm. Është e qartë që përshkrimet e djelmoshave nuk do ta bënin të mundur- në atë fazë- për të vlerësuar se Marjan Konaj mund të jetë një i dyshuar. Gjykatës asnjëherë nuk i është treguar se çfarë informacioni ka pasur Luke Perlala në lidhje me Marjan Konajn si i dyshuar.

Identifikimi i pasigurt i Marjan Konajt siç është përshkruar dhe konsideruar më lartë, nuk është dëshmi e mjaftueshme përtej dyshimit të arsyeshëm se Marjan Konaj ishte kryesi i veprës në këtë rast.

Një element i vogël është po ashtu se Dedë Perlala nuk u ka dhënë indikacion në asnjë mënyrë djelmoshave se ai e ka njohur qëlluesin.

A ka ndonjë dëshmi tjetër e cila së bashku me elementet e identifikimit, e bëjnë të sigurt faktin që Marjan Konaj është kryesi i veprës?

Gjykata konsideron se nuk ka dëshmi tjetër e cila e lidh Marjan Konajn me këtë rast.

Nuk ka dëshmi teknike për të mbështetur faktin që Marjan Konaj është kryesi i veprës. Nuk ka dëshmitarë okular (përveq tre djelmoshave) të cilët e kanë parë Marjan Konajn duke vozitur një makinë Opel-Kadett. (Qëlluesi ka vozitur makinë të tillë sipas deklaratës së djelmoshave).

Asnjë motiv nuk është vendosur që Marjan Konaj ta ketë vrarë Dedë Perlalën. Marjan Konaj duket që të ketë pasur marrëdhënie të mira me Dedë Perlalën. Asnjë dëshmitar nuk ka dhënë indikacione që Dedë Perlala ka pasur probleme në lidhje me Marjan Konajn.

Fakti që Marjan Konaj – disa orë pas të shtënave – ka shkuar në spital, tregon që nuk do të ishte e mundur që të vepronte ashtu po që se ai do të kishte qenë qëlluesi. Ai ka mundur të rrezikoj që të njihet nga ana e djelmoshave nëse do të paraqitej në spital pas një kohe aq të shkurtë pas të shtënave.

Nga pikëpamja e gjykatës, Marjan Konaj nuk ka pasur alibi për kohën kur kanë ndodhur të shtënat. Dëshmitarët e alibisë nuk e kanë bindur gjykatën se ai ka qenë në shtëpinë e Allakajve kur ka ndodhur vrasja në ora 08:00. Sidoqoftë, mungesa e alibisë nuk është një element me

rëndësi kundër Marjan Konajt-për ta mbështetur fajësinë e tij. Fakti që në ora 8:25 e ka thirrur gruan e tij tregon që ai në atë kohë nuk ka qenë në shtëpinë e Allakajve, sepse kjo telefonatë ishte regjistruar në një zonë që ishte jashtë zonës ku është e vendosur shtëpia e Allakajve.

Andaj- duke u bazuar në vlerësimet e përmendura-gjykata nuk gjen se ka dëshmi të mjaftueshme që tregojnë se Marjan Konaj është fajtor. Për këtë arsye Marjan Konaj është liruar nga Vrasja e Rëndë dhe Lëndime të Rënda Trupore.

Në lidhje me akuzën Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve, gjykata gjen se Marjan Konaj është fajtor. Gjykata e bazon këtë në faktin se policia, si rezultat të bastisjes, ka gjetur një revolver TT.nr. AA 703-1947 në shtëpinë e Marjan Konajt në kombinim me rrëfimin e tij në lidhje me këtë. Andaj ai do të dënohet sipas Nenit 328, paragrafit 2 i KPK-së.

Dënimi/Përcaktimi i Dënimit:

Gjatë shqiptimit të sanksionit penal, gjykata duhet që ti ketë parasysh që të dyja qëllimet e përgjithshme të dënimit- e ajo është për të shtypur aktivitetet e rrezikshme shoqërore duke i parandaluar të tjerët që të kryejnë akte të ngjashme penale, dhe qëllimi i veçantë- për të penguar kryesin e veprës nga kryerja e serishme e veprës. Në përcaktimin e gjatësisë së dënimit, gjykata duhet që ti vlerësoj të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, sipas Nenit 64, paragrafi (1) te KPK-së.

Sipas Nenit 328, paragrafi 2 i KPK-së, dënimi për një vepër të tillë është gjyba deri në 7.500 € ose burgim prej një deri në tetë vjet.

Gjykata konsideron se dënimi më burgim prej një viti është një reagim i përshtatshëm. Gjykata gjen se është me rëndësi që në Kosovë të jepen sinjale të forta që mbajtja në pronësi e armëve të paautorizuara do të dënohet rëndë.

Ky dënim ka përfunduar meqë Marjan Konaj ka qenë në paraburgim që nga 03 Marsi i vitit 2010.

Një dënim sekondar caktohet nga ana e gjykatës për konfiskimin dhe shkatërrimin e revolverit TT nr. AA 703- 1947, së bashku me karikatorin dhe tetë fishekët e kalibrit 7.62 mm.

Shpenzimet:

Shpenzimet e procedurës penale në lidhje me veprën penale për të cilën Marjan Konaj është shpallur fajtor do të paguhet nga ana e tij në shumë prej 100 Eurove si dhe 80 euro në emër të

paushallit gjyqësor, sipas Nenit 102, paragrafi 1 në lidhje me Nenin 99 paragrafi 2, nën paragrafi 6 i KPPK-së.

GJYKATA E QARKUT NË PEJË
P.nr. 336/10
E datës 22 Korrik 2011

Anëtar i trupit gjykues

Malcolm Simmons

Anëtar i trupit gjykues

Shaban Shala

Kryetar i trupit gjykues

Gunnar Oyhaugen



Procesmbajtëse

Vlora Johnston

Këshilla Ligjore

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi, me shkrim, përmes Gjykatës së Qarkut në Pejë, Gjykatës Supreme, në afat brenda 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, sipas Nenit 398, Paragrafi 1 i KPPK-së.